

VENDIM
Nr. 116, datë 30.9.2015

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 98, pika 2; 109 dhe 110/2, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.9.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me një ndryshim në “Rregullat e tregut të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 88, datë 30.6.2015, të Bordit të ERE-s, ndryshohet si më poshtë: “Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do t’i shtrijë efektet deri në datën 31.12.2015”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST, sh.a për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti